



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverballi i mbajtur më 14 qershor 2018, në mbledhjen e dytë (2) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.05

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, kryesues

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it dhe z. Skender Shatri – OSBE.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Mirë se keni ardhur, më lejoni të hapi mbledhjen e dytë të KKS-së. Ju falënderoj për pjesëmarrje. Sikurse u dakordua temat e rendit të ditës i kemi përcaktuar në mbledhjen e kaluar.

Rend i ditës

U miratua njëzëri

1. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Policisë z. Bekim Bislimi, por siç e kam theksuar edhe më parë përveç raportimeve nga Komandanti i Stacionit të Policisë dhe KFOR-it, kur është e nevojshme në aspektin e sigurisë, pjesë e raportimeve do të jetë edhe përfaqësuesi i FSK-së. Kjo të praktikohet në takimet e radhës.

z. Bekim Bislimi, gjendja e sigurisë në Komunë vlerësohet e qetë dhe stabile dhe nuk pritet në të ardhmen që të ketë eskalim në raport me sigurinë e përgjithshme. Gjatë periudhës në gjysmën e parë të këtij viti në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është shënuar rënie në përgjithësi të veprave penale, përkatësisht të vjedhjeve dhe

vjedhjeve të rënda. Prej rasteve më të ndieshme, sigurisht që keni dëgjuar përmes mjeteve të informimit, një rast i raportuar i grabitjes para dy ditësh ku personat e dyshuar janë arrestuar dhe gjatë kontrollit u janë konfiskuar edhe armë të cilat dyshohet se janë përdorur në rastin e cekur. Sa i përket gjendjes në komunikacion, mund të themi se është më e mirë duke marrë përbazë numrin e aksidenteteve të raportuara, duke llogaritur dëmet materiale, lëndimet etj., kjo periudhë ka shënuar rënie. Në gjendje shumë të mirë kemi sigurinë në shkollë, 100 % kemi raste më pak të raportuara krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, natyrisht falë bashkëpunimit me drejtorë të shkollave dhe Drejtorinë e Arsimit, kontaktit me prindër por edhe si rezultat i angazhimit të zyrtarëve policor dhe fushatës vetëdijësuese tek nxënësit. Me qëllim të parandalimit të dukurive negative që janë duke na përcjelluar, ne jemi komplet sa i përket planeve operative që i referohen komunikacionit, shkollave. E përsëris, për situatën në komunikacion kemi një gjendje më të mirë, kemi një prezencë të shtuar policore, shtimin e pikave të kontrollit dhe shqiptimit të kundërvajtjeve, besoj se do të ketë një trend pozitiv në të ardhmen me aplikimin e masave në komunikacion lidhur me pagesën e kundërvajtjeve, për çka në të kaluarën ka pasur një trend jo të mirë për shkak të ngarkesave të gjykatave dhe parashkrimit të lëndëve. Kjo është sa i përket raportit, nëse keni ndonjë pyetje jam në dispozicion të përgjigjem.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, situata në aspektin e sigurisë në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile. Kam vërejtur bashkëpunimin e Komunës me të gjitha institucionet tjera relevante dhe shpresoj se do të vazhdoj ky bashkëpunim.

z. Naim Bajraktari, sipas vlerësimit nga ana jonë-sektorit perkatës gjendja e sigurisë në komunë vlerësohet se është e qetë dhe stabile. Një tog prej 30 pjestarëve dhe të mjeteve perkatëse është në gatishmëri 24 orë dhe 365 ditë në funksion të shërbimit të qytetarëve. Kjo ishte sa i përket gjendjes së sigurisë.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, sipas raportimit u konstatua se gjendja e sigurisë publike është e qetë dhe stabile, numri i veprave penale është në rënie, mirëpo na nevojitet punë dhe angazhime të mëtejme me qëllim të zvogëlimit edhe më shumë të këtyre veprave. Nëse nuk ka dikush diçka rreth raporteve të paraqitura kalojmë në pikën e radhës.

2. Miratimi i propozimit të Planit të punës të KKS-së për vitin 2018

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, në mbledhjen e kaluar kemi ngritur grupin punues për hartimin e planit të punës së KKS-së për vitin 2018. Fjalën e ka kryesuesi i grupit z. Faik Muçiqi.

z. Faik Muçiqi, theksoi, kemi mbajtur dy takime për hartimin e draftit të planit të punës së KKS-së edhe pse ka qenë kohë e shkurtër besoj se kemi arritur të përafrojmë këtë plan. Plani parasheh periudhën nga muaji qershor deri në fund të vitit, diku parashihen 23 aktivitete dhe tema që duhet ti trajtojmë. Kryesuesi i grupit foli në detaje për të gjitha aktivitetet, për bartësit dhe raportuesit e atyre aktiviteteve. Ndër tjera foli edhe për procesverbalin, theksoi se nuk duhet të jet stenogram, por procesverbal ku do të përfshiheshin vetëm çështjet esenciale dhe përmbajtësore, pra nga takimi të kemi procesverbale dhe jo stenograme.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, e hap debatin për propozim Planin e Punës. Nëse nuk keni diçka e hedh në votim.

Konstatim:

Propozimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2018, pas votimit njëzëri rekomandohet për miratim në Kuvendin e komunës.

3. Përgatitjet për masat parandaluese kundër zjarrit gjatë sezonit të verës

-Informatë nga Shërbimi i Zjarrfikësve

-Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, fillimisht fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Vezir Januzi.

z. Vezir Januzi, theksoi, kam përgatitur një informatë lidhur me temën. Drejtori në formë statistikore dha të dhëna mbi sipërfaqen pyjore në territorin e komunës, prej tyre 15110 ha në pronë shtetërore dhe 11852 ha në pronë private. Gjithashtu foli edhe për kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore sa i përket mbrojtjes së pyjeve shtetërore dhe atyre në pronësi private si dhe për ndarjen e sipërfaqeve pyjore në Njësi menaxhuese, dhe për njësitë e ndara në Rajone Ekonomiko-Pyjore(REP).

Drejtori foli edhe për rastet e shfaqjes së zjarreve, ku theksoi se gjatë vitit 2017 ka pasur 40 raste të zjarreve që kanë përfshirë sipërfaqe prej 123,65 ha ndërsa gjatë kësaj periudhe të vitit 2018 ka pasur 11 raste në shtrirje prej 26.10 ha. Përfundoi, përpos stafit komunal, APK ka angazhuar edhe 15 punëtorë sezonal të cilët do të jenë në kujdestari aktive në rast të shfaqjes së zjarreve.

z. Faik Muçiqi, informoi të pranishmit për punët dhe aktivitetet e Shërbimit të Zjarrfikësve lidhur me intervenimet dhe masat parandaluese kundër zjarreve gjatë sezont të verës. Theksoi, nga muaji janar deri më 01 qershor 2018 shërbimi i zjarrfikësve ka intervenuar në 136 raste, prej tyre 42 raste të djegjes së pyjeve, ndërsa të tjerat kryesisht intervenime tjera siç janë rastet e aksidenteve, gjatë vërshimeve etj. në sipërfaqe afërsisht prej 21 ha. pyje, dërsa të tjera fusha etj. Një indikacion që po na persëritet, e që nuk kemi mundur të trajtojmë është faktori njeri, sepse gjatë kësaj periudhe asnjë zjarr nuk është shkaktuar nga temperaturat e larta dhe kjo mbetet brengë që Policia, Drejtoritë përkatëse, Agjencioni i pyjeve dhe të subjektet tjera relevante të merren më shumë me shkaktarët e zjarreve.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, e hap diskutimin lidhur me informatat e paraqitura. Unë kam interesim për atë ku thuhet se gjatë vitit 2017 ka pas 40 raste të zjarreve, në informatë ceken të dhëna si informacione apo të dhëna statistikore, se kush ka marr pjesë në shuarje etj. por nuk kemi asnjë informatë për shkaktarët e zjarrit, a keni ndonjë të dhënë për rastet e zbuluara apo jemi duke u marrë vetëm me pasojat.

z. Vezir Januzi, sipas të dhënave që disponojmë, kemi informata vetëm për pasojat por jo edhe të dhëna tjera, por kryesisht faktori njeri është shkaktari i shfaqjes së zjarreve.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, nëse nuk ka dikush diçka tjetër kalojmë në pikën e radhës.

3. Të ndryshme

z. Naim Bajraktari, theksoi, Batalioni i III-të i reagimit të shpejtë që vepron në kuadër të Brigadës së reagimit të shpejtë në Mitrovicë, në kuadër të përgjegjësisë së këtij Batalioni që është edhe Komuna jonë kanë përfunduar të gjitha ushtrimet në komunat tjera e që janë pesë dhe ka mbetur vetë Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna jonë. Ka qenë kërkesë e tyre që ta bëjmë një ushtrim të përbashkët me të gjithë akterët e emergjencës. Kjo është në kuadër të planit të veprimit vjetor të FSK-së, pa kosto financiare për komunën, por që i shërben nivelit të sigurisë. Këtu kemi mundësi t'i testojmë aftësitë dhe kapacitet tona të emergjencës si në aspektin operativ dhe të organizimit. z. Faik Muçiqi,

në bazë të përgjegjësiave do të jetë bartësi kryesor i Komunës, ndërsa periudha e paraparë për ushtrimin është mars – qershor 2019. Anë pozitive e këtij aktiviteti është ngritja e nivelit të sigurisë në Komunë. Nëse ju dakordoheni atëherë mund të koordinohemi.

z. Agim Velu, Kryetar i Komunës, theksoi, ne jemi dakord që FSK të zhvillojë aktivitetin në Komunën e Podujevës, të paraqitur nga përfaqësuesi i FSK.

Kryetari përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 10.45

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/04-0048483/18
Podujevë,
14 qershor 2018**

**Kryetari i Komunës
Agim Velu**